

PRISHTINA,
pa barriera dhe me
qasje të lehtë për të
gjithë, kudo dhe kurdo



RAPORTI 2016

**Prishtina
po bëhet**



QËLLIMI DHE VIZIONI YNË PËR QYTETIN

Qëllimi politik i qeverisjes sonë që nga fillimi ka qenë dhe vazhdon të jetë në bërjen e qytetit të Prishtinës – qytet për të gjithë. Me këtë në mendje, kemi qenë këmbëngulës që të gjitha projektet që realizohen në Komunën e Prishtinës, të bëhen duke trajtuar nevojat dhe kërkesat e qytetarëve tonë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.

Vizioni ynë për Prishtinën është një Prishtinë me mundësi të barabarta për të gjithë, ku secilit t'i jepet mundësia të jetojë, krijojë dhe të punojë. Prishtina duhet të bëhet qyteti, ku qytetarët e saj ndihen krenar për qytetin e tyre të cilin po e ndërtojmë së bashku.

Përkundër punëve dhe projekteve që kemi realizuar këto tri vite për të siguruar qasje për të gjithë, për realizimin e vizionit tonë për Prishtinë – qytet të qasshëm për të gjithë, mbetet shumë punë për t'u bërë.

Për të realizuar vizionin tonë për Prishtinën, jemi fokusuar në tri fusha të integritit të personave me nevoja të veçanta:

Në Prishtinë, çdo qytetar, pa dallim, do të ketë mundësi të barabarta që të jenë pjesë aktive në shoqëri.

- Integrimin e të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet edukativo – arsimore;
- Integrimin e personave me nevoja të veçanta në institucione;
- Krijimin e mundësive për integrim të plotë në shoqëri, përmes eliminimit të barrierave fizike.



Komuna e Prishtinës i ka të punësuar 2 persona me nevoja të veçanta dhe në vitin 2015 është angazhuar një praktikant me nevoja të veçanta për tu aftësuar për punë në administratë publike.


Fusha e tretë ku jemi fokusuar, është krijimi i mundësive për integrim të plotë në shoqëri përmes eliminimit të barrierave fizike. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Urbanizmit, kanë krijuar grupin punues, të përbërë nga tre inxhinierë të arkitekturës, dy inxhinierë të ndërtimtarisë dhe zyrtarë të tjerë të Komunës, që në bashkëpunim me "Handikos" dhe Shoqatën e të Verbërve të bëjnë identifikimin e pengesave në:

- Barrierat në institucionet publike - objekte komunale, shkolla dhe qendra të Mjekësisë Familjare;
- Barrierat në trotuare dhe vendkalime për këmbësorë;
- Barrierat në parkingje;
- Barrierat në banesat kolektive ku banojnë personat me nevoja të veçanta;
- Gjendjen e pjerrinave dhe ashensorëve.

Pas përfundimit të identifikimit të barrierave, të dy drejtoritë, duke përfshirë edhe Drejtorinë e Infrastruktursë, janë angazhuar që të eliminojnë disa nga barrierat ku Komuna e Prishtinës ka pasur mundësi të intervenojë.

Po ashtu, në bazë të marrëveshjes që ka Komuna e Prishtinës me GLZ , kanë ndihmuar HANDIKOS-in për realizimin e hulumtimit mbi barrierat fizike në ndërtesat publike në qytetin e Prishtinës, si dhe hulumtimin mbi gjendjen e fëmijëve në rrugët e Prishtinës.

Nga viti 2014, të gjitha planet dhe projektet që i implementon Komuna, bëhen në përputhje me Udhëzimin administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara. E njëjta aplikohet me lejet për ndërtim, kur kërkohen nga kompanitë private.



Në Prishtinë, çdo fëmijë mundet! Ky ishte slogani ynë në fushatën parazgjedhore në vitin 2013. U zotuam që Prishtinën ta bëjmë qytet, ku çdo fëmijë, pa marrë parasysh gjendjen fizike, mendore, ekonomike dhe sociale, do të ketë mundësi të arrijë. U zotuam që të gjithë fëmijët do të trajtohen, ndihmohen dhe do të integrohen në të gjitha aspektet e shoqërisë.

Gjendja të cilën e trashëguam, nuk ishte aspak e mirë në sistemin arsimor dhe në atë shëndetësor ku mungonte trajtimi i barabartë i të gjithë fëmijëve, e sidomos i atyre me nevoja të veçanta. Synimi ynë është që shkolla të jetë një vend ku çdo fëmijë ka mundësi të arrijë, të ndjehet i pranuar dhe i vlerësuar dhe të përfitojë maksimalisht nga procesi mësimor.

Në bazë të mundësive dhe kapaciteteve financiare dhe njerëzore, Komuna e Prishtinës, në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi, ka filluar me programin për integrimin e të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta në çerdhe dhe shkolla. Në kuadër të programit është krijuar ekipi vlerësues profesional për fëmijë me nevoja të veçanta, i cili do të kujdeset që të bëjë integrimin dhe monitorimin e fëmijëve në institucionet edukativo-arsimore, si dhe do të japë rekomandime për adresim më efektiv të problemeve.

Për të realizuar programin për gjithëpërfshirje, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës ka punësuar 14 psikologë dhe 3 mësuese mbështetëse, katër mësues/e të klasave të bashkëngjitura, të cilët merren me nxënësit me nevoja të veçanta, por edhe me nxënësit që kanë vështirësi në të nxënë, e po ashtu i kemi dhe tre mësues të gjuhës së shenjave (dy në SHML "28 Nëntori") dhe një në SHFMU "Elena Gjika", si dhe shumë asistentë privatë që paguhën nga prindërit.

Gjithë përfshirja në shkolla nënkupton edukimin e fëmijëve në frymën e solidaritetit, bashkëpunimit dhe edukimit të të gjithë fëmijëve për një shoqëri të barabartë për të gjithë.

Komuna e Prishtinës tani ka gjithsej 3 klasa të bashkëngjitura në SHFMU "Elena Gjika", ku janë 3 nxënës me nevoja të veçanta (shurdhmemec); SHFMU "Ismail Qemali", vijojnë mësimin 6 nxënës me nevoja të veçanta (autizëm); SHFMU "Zenel Hajdini", klasa e bashkëngjitur me 3 nxënës me nevoja të veçanta, prej të cilëve dy janë me dëmtime intelektuale dhe një me dëmtime të shumëfishta. Shumë shpejt nxënësit e këtyre klasëve do të integrohen në klasa të rregullta.

Integrimi i fëmijëve në vitin shkollor 2015/16

Institucionet parashkollore, 32 fëmijë;
Shkollat fillore të mesme të ulëta, 274 nxënës;
Shkollat e mesme të larta, 25 nxënës.

Integrimi i fëmijëve në vitin shkollor 2016/17

Institucionet parashkollore, 39 fëmijë;
Shkollat fillore të mesme të ulëta, 368 nxënës;
Shkollat e mesme të larta, 31 nxënës.



PROBLEMET dhe VËSHTIRËSITË

Gjithë përfshirja është proces i cili nuk mund të arrihet brenda një kohe të shkurtër. Pavarësisht vullnetit, dëshirës dhe punës së palodhshme të ekipit për të krijuar një sistem gjithëpërfshirës edukativo-arsimor, ne çdo ditë ballafaqohemi me probleme, vështirësi dhe sfida të shumta, të cilat në shumë raste nuk varen nga Komuna e Prishtinës.

Numri i pamjaftueshëm i mësueseve-edukatorëve mbështetës dhe mungesa e përgatitjes për punë me fëmijë me nevoja të veçanta, e bën procesin e gjithëpërfshirjes sfidues. Edhe pse gjatë rrugës sfidohemi në shumë mënyra dhe me shumë probleme, ne jemi të vendosur të punojmë pa ndalur në krijimin e një sistemi edukativo-arsimor gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët, pa dallim.

Prishtina bëhet qytet për të gjithë, atëherë kur arrijmë t'i eliminojmë të gjitha barrierat për personat me nevoja të veçanta. Përkundër vështirësive, Komuna e Prishtinës ka vullnetin që, me aq sa ka mundësi, t'i eliminojë barrierat në objekte shkollore, qendra të Mjekësisë Familjare, objekte komunale dhe rrugë.

Përkundër vullnetit dhe dëshirës për ta bërë Prishtinën qytet për të gjithë, dhe përkundër intervenimeve që ka bërë Komuna e Prishtinës për tri vjetët e fundit, kufizimet buxhetore dhe gjendja shumë e rëndë të cilën e trashëguam, mbesin barrierat kryesore për të realizuar vizionin tonë për Prishtinën. Gjendja të cilën e gjetëm Prishtinën në vitin 2014, ishte e rëndë në të gjitha aspektet, përfshirë edhe qasjen e lirë për të gjithë. Ne gjetëm Prishtinën me barrierat të shumta, jo vetëm për personat me nevoja të veçanta, por për të gjithë. Ishte e pamundur të lëvizje lirshëm dhe sigurt edhe në trotuare.

Çfarë bëmë ne?

Filluam me eliminimin e barrierave në trotuare, duke vendosur shtylla anti-parking për të ndaluar bllokimin e tyre nga veturat e shumta. Vazhduam me ngritjen dhe shënjimin e vendkalimeve, duke bërë nivelimin e tyre me trotuaret, si dhe ndriçimin e tyre. Evidentuam barrierat në objektet komunale, qendrat e Mjekësisë Familjare dhe në objektet shkollore.

Intervenimet në objekte shkollore, qendra të Mjekësisë Familjare, objekte komunale, transport dhe rrugë:

SHFMU "ISMAIL QEMALI"

Në bashkëpunim me DEMOS, Komuna e Prishtinës ka ridizajnuar të gjithë oborrin e shkollës fillore "Ismail Qemali", e cila mbetet një ndër shkollat me numrin më të madh të fëmijëve. Projekti është realizuar në përputhje me Udhëzimin administrativ, UA 33/2007, në mënyrë që t'iu mundësohet qasje sa më e lehtë nxënësve, stafit edukativ dhe prindërve me nevoja të veçanta.






Identifikimi dhe projektimi i pjerrinave edhe në këto shkolla fillore:



- SHFMU "Dardania"
- SHFMU "Faik Konica"
- SHFMU "Hasan Prishtina"

Shkolla fillore "Dardania" - Prishtinë
Gjendja ekzistuese



P=1:50

Foto 1:
Gjendja ekzistuese
në shkollën "Dardania "



P=1:50

Foto 2:
Gjendja e propozuar
në shkollën "Dardania "

Identifikimi i problemeve dhe intervenimet në qendra të Mjekësisë Familjare për qasjen e personave me nevoja të veçanta:

Intervenimet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe Qendrën e Mjekësisë Familjare –VI:

Në këto dy qendra mjekësore janë instaluar ashensorët.



Identifikimi dhe intervenimi në institucione komunale

Qasja për persona me nevoja të veçanta në ndërtesën kryesore të Komunës së Prishtinës ka munguar. Gjatë vitit 2015, filluam me dy projekte, instalimin e ashensorit panoramik, i cili u siguron qasje personave me nevoja të veçanta në të gjitha katet e ndërtesës dhe instalimin e lift-platformës, që i siguron qasje në katin përdhese, ku ofrohen shërbimet komunale.

Foto: Objekti i vjetër i Komunës, Prishtinë – instalimi i platformës dhe ashensorit



Intervenimet në VENDKALIME

Për të siguruar qasje të lehtë dhe të sigurt për të gjithë, sidomos për personat me nevoja të veçanta, është intervenuar në vendkalimet më të frekuentuara. Intervenimet në vendkalimet e këmbësoreve, përfshijnë intervenimet në ngritjen e nivelit të vendkalimeve apo ulja e vendkalimeve dhe nivelimin e tyre me trotuare, vendosjen e pllakave taktile dhe instalimin e sistemit të tingëlloreve nëpër semaforë.

Instalimi i sistemit të tingëlloreve për personat e verbër në 15 pikat më të frekuentuara:



Instalimi i sistemit të tingëlloreve nëpër semaforë në rrugën e UQK-së

Rrugët ku janë projektuar dhe bërë intervenimet: rr. "Garibaldi", rr. "Perandori Justinian", rr. "Dëshmorët e Kombit", rr. "Luan Haradinaj", rr. "Agim Ramadani", rr. "Rexhep Luci", rr. "Tringë Smajli", rr. "Eqrem Çabej", rr. "Robert Doll", rr. "Tirana", rr. "Pashko Vasa", rr. "Mujo Ulqinaku", rr. "Fehmi Agani", rr. "Radovan Zogoviç", rr. "Mbreti Zog", rr. "Kosta Novakoviç", rr. "Bill Clinton".




Foto: Rruga "Fehmi Agani" – Vendkalimi rasti i I-rë.




Foto: Rruga "Fehmi Agani" –Vendkalimi rasti i II-të.




Foto: Rruga "Fehmi Agani" –Vendkalimi rasti i III-të.



Foto: Rruga "Fehmi Agani" –Vendkalimi rasti i IV-të.

Intervenimet në rrugën "Garibaldi"



Foto: Projekti i Rr."Garibaldi"

Adaptimi i trotuareve dhe realizimi i shiritit për të verbër dhe pllaka taktile, u dedikohen personave me të pamur të dëmtuar. Është arritur të sigurohet qasje e lehtë për të gjithë, pa barrierë fizike.



Foto : Gjendja ekzistuese në rr. "Garibaldi" – trotuari



Foto : Gjendja ekzistuese në rr."Luan Haradinaj" –trotuari



Foto:Rikonstruktimi i trotuarit–rr."Garibaldi" –"Perandori Justinian"

Identifikimi dhe intervenimi në hapësirat publike



**Lista e parkingjeve për persona me nevoja të veçanta
Në Hapësira Publike**

Identifikimi i intervenimeve në hapësira publike ,institucione dhe parqe:

Stacioni i autobusëve, parku "Gërmia", objekti i Komunës së Prishtinës (ndërtesa e re), Qendrat e Mjekësisë Familjare, Kino "ABC", përballë Galerisë së Arteve, qasja për te Rektorati, sheshet: "Zahir Pajaziti", "Ibrahim Rugova", "Nëna Terezë", prapa Ambasadës së Kroacisë rr."Fehmi Agani", te rr. "Sadik Bekteshi, në të gjithat pikat e postave, Qendra për Punë Sociale, në të gjitha bankat.

Realizimi i parkingjeve publike për personat me nevoja të veçanta në rrugët: rr. "Sylejman Vokshi", rr. "UÇK-së", rr. "Agim Ramadani", rr. "Tringë Smajli", rr. "Hajdar Dushi", rr. "Dëshmorët e Kombit", rr. "Idriz Gjilani", rr. "Luan Haradinaj", rr. "Fehmi Agani", rr. "Bill Klintoni", sheshi "Isë Boletini", rr. "Iljaz Kodra", rr. "Lekë Dukagjini", rr. "Mark Isaku", rr. "Rexhep Mitrovica".

RASTET INDIVIDUALE

Identifikimi i parkingjeve për personat me nevoja të veçanta për raste individuale, është realizuar identifikimi bërë për 16 persona me nevoja të veçanta.

Gjatë muajit maj 2015, janë bërë vizitat nëpër banesat kolektive ku banojnë personat me nevoja të veçanta, sipas listës që është dhënë nga "Handikos". Janë bërë identifikimet e pengesave dhe është bërë plani ku do të vendosen pengesat - "laurat" dhe ashensorët që mundësojnë qasjen në banesat e tyre.

Janë realizuar projektet për 7 raste, të cilat gjenden në lagjen "Dardania", "Kodra e Diellit", "Arbëria" dhe "Ulpiana".





Foto :
Lokacioni i rasteve
individuale –
Për personat me nevoja
të veçanta



Foto : Lokacioni i rasteve individuale –Për Personat me nevoja të veçanta
(Dardani, Ulpianë dhe Bregu i Diellit)



Ndërsa për personat që kanë nevojë për përdorim të ashensorit, janë bërë analiza dhe matje se ku ka mundësi të vendoset ashensori për rastet dhe projekti pritet të realizohet gjatë vitit 2017. Ashensorët do të instalohen në 7 ndërtesa banesore, për t'iu mundësuar qasje 7 personave me nevoja të veçanta.

Foto : Realizimi i pjerrinës ne lagjen "Kodra e Diellit "

TRANSPORTI PUBLIK



Komuna e Prishtinës nuk ka transport funksional i cili i përmbush nevojat e qytetarëve. Mungesa e transportit publik ka vështirësuar lëvizjen e lirë të personave, e posaçërisht personave me nevoja të veçanta, të cilët nuk kanë lëvizur fare në qytet apo janë detyruar të gjejnë mënyra të tjera të lëvizjes. Për të zgjidhur këtë problem, Komuna e Prishtinës në fillim të vitit 2014, ka filluar projektin për reformimin e tërë transportit publik. Reformimi i transportit publik nënkupton krijimin e një transporti publik funksional, të qasshëm për të gjithë. Në këtë projekt përfshihen blerja e 51 autobusëve të rinjë, me standarde evropiane, dhe qasje të lehtë për të gjithë, e cila mundësohet përmes platformës që i përshtatet nevojave të udhëtarëve dhe hapësirën e dedikuar për persona me karroca, si dhe sinjalin për persona të verbër. Pjesa tjetër e projektit është realizimi i planit të mobilitetit urban, i cili do të

mundësojë krijimin e linjave të reja dhe stacioneve pritëse, shtigje të sigurt për këmbësor, persona me aftësi të kufizuara dhe çiklistë. Plani i mobilitetit urban do të realizohet në bashkëpunim me të gjitha grupet e interesit, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e personave me nevoja të veçanta.

Ku kemi arritur?

Përkundër bllokadave të qëllimshme politike, presioni i përbashkët qytetarë bëri që ky projekt të fillojë të realizohet. Lansimi i autobusëve për qarkullim bëhet në muajin janar të vitit 2017, kur edhe do të kemi 30 autobusë në qarkullim, dhe 21 autobusë të tjerë i shtohen flotës në muajin mars 2017. Plani i mobilitetit ka filluar dhe do të përfundoj në verë të vitit 2017. Në bazë të planit do të dizajnohen linjat e reja për autobusë dhe stacionet pritëse, duke marrë parasysh nevojat e qytetarëve.

